Nr. Prot. 01-06
Dt. 06.01.2025

UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI" PRIZREN
Rruga e Shkronjave Nr. 1, 20000
Prizren, Republika e Kosovës
www.uni-prizren.com

RREGULLORE PËR PROCEDURAT PËRZGJEDHËSE LIDHUR ME EMËRIMIN, RIEMËRIMIN DHE AVANCIMIN E PERSONELI AKADEMIK NË UNIVERSITETIN "UKSHIN HOTI" PRIZREN

Prizren, 2025

Mbështetur në kompetencat e përcaktuara me nenin 169, paragrafi 1 të Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Arsimin e Lartë nr. 04/L-037, Ligjit të Punës nr. 03/L-212, Rregullorja (AKA) Nr 04/2024 për Manualin E akreditimit/ riakreditimit dhe validimit të institucioneve të arsimit të lartë, Neni 12, paragrafi 4, Senati i Universitetit "Ukshin Hoti", në mbledhjen e datës 6.1.2025, miratoi:

RR E G U LL O R E

PËR PROCEDURAT PËRZGJEDHËSE LIDHUR ME EMËRIMIN, RIEMËRIMIN DHE AVANCIMIN E PERSONELIT AKADEMIK NË UNIVERSITETIN "UKSHIN HOTI" PRIZREN

Neni 1
Qëllimi

1. Kjo rregullore ka për qëllim rregullimin dhe përcaktimin e procedurave përzgjedhëse dhe procesin për emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në thirrjet profesor i rregullt, profesor i asocuar, profesor asistent, asistent dhe lektor në të gjitha fakultetet, përveç Fakultetit të Arteve, përkatësisht pozitave që i takojnë fushës së arteve.

2. Çështjet, që nuk janë rregulluar në mënyrë shprehimore në Statutin e Universitetit "Ukshin Hoti" lidhur me procedurat vlerësuese për emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik, rregullohen në dispozitat vijuese të kësaj rregulloreje.

Neni 2
Përkufizimet

1. Monografi konsiderohet edhe punimi i doktoratës në formë monografie, i publikuar si botim i veçantë, në Kosovë ose vende tjera, me ISBN dhe i katologuar. Në rastin e kandidatëve që kanë doktoruar në universitetet jashtë Kosovës dhe të vendeve fqinje, mjafton dëshmia e katologimit të punimeve të doktoratës në biblioteka përkatëse. Kandidati duhet të posedojë së paku një monografi.

2. Tekst mësimor konsiderohet libri në gjuhën shqipe ose në gjuhë të huaj, për nevoja të studentëve në fushën përkatëse. Libri duhet të jetë i botuar në formë të shtypur apo elektronike, të jetë i shqyrtuar nga së paku dy recensentë, së paku me titull dr. sc. në fushën e njëjtë ose të afërt dhe të ketë ISBN. Pranohet edhe teksti për përdorim të brendshëm me ligjërata/ushtrime, i botuar në formë të shtypur ose elektronike, i shqyrtuar nga së paku dy recensentë, së paku me titull dr. sc. në fushën e njëjtë ose të afërt. Kandidati për thirrjen profesor i rregullt duhet të ketë së paku një tekst mësimor.

3. Kandidati mund të konsiderohet si autor i parë ose korrespondent i punimeve të publikuara në revista shkencore vetëm nëse plotësohen kriteret e specifikuara në paragrafin A të Shtojcës II të kësaj rregulloreje dhe duke respektuar dispozitat kalimtare të kësaj rregulloreje.

4. Kandidati për thirrjen profesor i rregullt duhet të dëshmojë pjesëmarrje në së paku tre konferenca (simpoziume ose kongrese), nga të cilat së paku një ndërkombëtare.

5. Kandidati për thirrjen profesor i rregullt duhet të dëshmojë pjesëmarrje në së paku 1 projekt (individual ose grupor) në fushën në të cilën aplikon, rezultatet e të cilit janë publikuar në ndonjë formë ose janë prezantuar para një auditoriumi p.sh. në njësi akademike ose forum tjetër ekuivalent.

6. Kandidati për thirrjen profesor i rregullt duhet të dëshmojë se ka mentoruar me sukses së paku dy tema master dhe ka mentoruar ose është në proces të mentorimit të së paku një kandidati në studimet e doktoratës. Në mungesë të dëshmisë së mentorimit të studentëve të doktoratës, kandidati duhet të dëshmojë që është së paku në proces të bashkëmentorimit të një kandidati (nuk pranohet më shumë se një bashkëmentor për një doktorant) ose të ketë marrë pjesë në së paku një komision për mbrojtje/vlerësim të punimit të doktoratës dhe të ketë botuar në cilësinë e autorit të parë së paku një punim më shumë se minimumi i nevojshëm për thirrjen profesor i rregullt. Punimi duhet t'i plotësojë kriteret e specifikuara në paragrafin A të Shtojcës II.

7. Kandidatët për thirrjen e profesorit asistent duhet të dëshmojnë se posedojnë së paku dy certifikata për metodologji të mësimdhënies, të fituara në Qendrën për Përsosmëri në Mësimdhënie të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, respektivisht në institucione të ngjashme ndërkombëtare. Për kandidatët e jashtëm pranohet edhe referenca për aftësinë pedagogjike nga shefi i departamentit/programit ose dekani i njësisë përkatëse akademike, në të cilën kandidati ka realizuar përvojën e nevojshme të punës, e cila shërben si zëvendësim i përkohshëm i certifikatave nga QPM-ja, por që nuk vlerësohet me pikë.

8. Gjatë vlerësimit të kandidatëve për avancim mund të pranohen edhe punimet, për të cilat ka konfirmim nga revistat përkatëse se janë të pranuara (accepted) për t'u publikuar, me kusht që të mos ketë kandidatë tjerë që i plotësojnë kushtet tjera dhe tashmë kanë numrin përkatës të punimeve të publikuara. Në këtë rast vendimi përfundimtar merret pas publikimit të punimit, por brenda kohëzgjatjes së afatit të konkursit.

9. Kandidatët që aplikojnë në pozitat si asistent, profesor asistent, profesor i asocuar dhe profesor i rregullt të cilët kanë patur thirrje paraprake në Universitetin "Ukshin Hoti" Prizren, apo kanë qenë të angazhuar në UUHP, në kushte të barabarta duke plotësuar kriteret minimale të parapara me këtë rregullore, kanë përparësi kundrejt kandidatëve të tjerë në procesin e konkursit.

Neni 3
Personeli akademik

Në pajtim me nenin 167, paragrafi 2, të statutit, personeli akademik i universitetit (përveç Fakultetit të Arteve) përbëhet nga: profesorë të rregullt, profesorë të asocuar, profesorë asistentë, asistentë universiteti dhe lektorë.

Neni 4
Kriteret për emërimin në thirrje akademike

1. Procedura vlerësuese për emërim në thirrje akademike mbështetet në kriteret që dalin nga aktivitetet në vijim:

   (1) Aktiviteti arsimor – shtojca I;
   (2) Aktiviteti hulumtues, shkencor dhe profesional – shtojca II;
   (3) Aktiviteti shërbyes – shtojca III;
   (4) Vlerësimi kuantitativ i aktiviteteve të kandidatëve shtojca IV.

2. Për emërimin e kandidatëve në thirrjen përkatëse kërkohet plotësimi i minimumit të kritereve të parapara në Statutin e UUHP-së, përkatësisht në shtojcat përkatëse të kësaj rregulloreje.

3. Nëse për pozitën e caktuar të shpallur në konkurs aplikon së paku 1 kandidat, i cili për atë pozitë ka thirrjen përkatëse siç parashihet me Statutin e Universitetit, vlerësimi i kandidatëve për atë pozitë bëhet bazuar në shtojcat I, II dhe III. Në të kundërtën, vlerësimi bëhet bazuar në shtojcat I, II, III dhe IV, duke i dhënë përparësi kandidatit me më shumë pikë.

4. Shtojcat I, II, III dhe IV janë pjesë përbërëse të kësaj rregulloreje.

Neni 5
Emërimi në thirrjen e profesorit të rregullt

1. Në pajtim me nenin 170 të Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti", kushtet për emërimin dhe avancimin në çfarëdo titulli të personelit akademik janë kualifikimet përkatëse dhe përvojat relevante për vendin e punës.

2. Në pajtim me nenin 171 të Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti", për titullin e profesorit të rregullt të fakultetit, kandidati duhet të ketë këto kualifikime:

   2.1. Të ketë gradën e doktorit të shkencës (ekuivalente me të në Fakultetin e Arteve);
   2.2. Të tregojë nivel të lartë dhe kompetencë akademike e përvojë shkencore për lëndën që dëshmohet me:
   2.2.1. Një numër të rëndësishëm të monografive, teksteve mësimore, publikimeve në revista ndërkombëtare shkencore ose artistike me së paku pesë (5) punime kryesore të publikuara në revista shkencore ose artistike ndërkombëtare si autor i parë ose korrespodent;
   2.2.2. Pjesëmarrje aktive në konferencat kombëtare dhe ndërkombëtare;

2.2.3. Krijime ose punime të njohura artistike ose të ketë pasur prezentime publike dhe të ketë kontribuar kur është rasti i Fakultetit të Arteve, në mënyrë të veçantë duhet të ketë kontribuar në zhvillimin e kulturës dhe të artit;
2.2.4. Përvojë afatgjate në projekte të kërkimeve themelore dhe të aplikueshme;
2.2.5. Aftësi të lartë arsimore dhe pedagogjike përmes praktikës së arsyeshme;
2.2.6. Aftësi për udhëheqje akademike;
2.2.7. Udhëheqje të temave master dhe të doktoratës.

Neni 6
Emërimi në thirrjen e profesorit të asocuar

1. Në pajtim me nenin 170 të Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti", kushtet për emërimin dhe avancimin në çfarëdo titulli të personelit akademik janë kualifikimet përkatëse dhe përvojat relevante për vendin e punës.

2. Në pajtim me nenin 172 të Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti", për titullin e profesorit të asocuar, kandidati duhet të ketë këto kualifikime:

   2.1. Të ketë thirrjen e doktorit të shkencës (ekuivalente me të në Fakultetin e Arteve);
   2.2. Të ketë një numër të zgjedhur të monografive, publikimeve në revista ndërkombëtare shkencore ose artistike, me së paku tre (3) punime kryesore të publikuara në revista ndërkombëtare si autor i parë ose korrespodent;
   2.3. Të ketë krijuar punime të vërteta artistike ose të ketë pasur prezentime publike, kur është rasti për Fakultetin e Arteve;
   2.4. Të tregojë aftësi për mësimdhënie;
   2.5. Të dëshmojë punë, dije dhe mjeshtëri në lëndën e fushës përkatëse.

Neni 7
Emërimi në thirrjen e profesorit asistent

1. Në pajtim me nenin 170 të Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti", kushtet për emërimin dhe avancimin në çfarëdo titulli të personelit akademik janë kualifikimet përkatëse dhe përvojat relevante për vendin e punës.

2. Në pajtim me nenin 173 të Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti", për titullin e profesorit asistent, kandidati duhet të ketë këto kualifikime:

   2.1 Të ketë gradën e doktorit të shkencës;
   2.2. Të ketë numër të zgjedhur të monografive dhe publikimeve të shqyrtuara në revista ndërkombëtare shkencore ose artistike me së paku një punim kryesor të publikuar dhe të shqyrtuar në revista ndërkombëtare si autor i parë ose korrespodent;
   2.3. Të ketë krijuar punime artistike ose të ketë pasur prezentime publike, kur është fjala për Fakultetin e Arteve;
   2.4. Të tregojë aftësi për mësimdhënie.
   2.5. Të ketë së paku tre (3) vite përvojë pune në procesin mësimor në Universitet.

3. Si përvojë pune në frymën e pikës 1.4 konsiderohet përvoja, të cilën kandidati e ka arritur në procesin mësimor, si i zgjedhur ose i angazhuar, së paku 6 semestra, në Universitet.

4. Kandidatët që aplikojnë në thirrjen e Profesorit Asistent sipas kësaj rregulloreje, duhet të kenë së paku një punim shkencor në revista të indeksuara në platformat "Web of Science" apo "Scopus", në rast të kundërt dosja konsiderohet si e pakompletuar, rrjedhimisht, nuk i nënshtrohet vlerësimit të komisionit recensues.

Neni 8
Emërimi në thirrjen e asistentit të universitetit

1. Në pajtim me nenin 174 të Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti", për titullin e asistentit të universitetit, kandidati duhet t'i plotësojë këto kushte:

   1.1. Të ketë të përfunduar me sukses studimet master në drejtimin përkatës;
   1.2. Të jetë jo më i vjetër se njëzet e tetë (28) vjet kur emërohet për herë të parë;
   1.3. Të jetë i regjistruar në studimet e doktoratës në Universitet me rastin e rizgjedhjes;
   1.4. Të ketë notën mesatare në studimet baçelor dhe master jo më pak se tetë (8), në secilën prej këtyre studimeve.

Neni 9
Emërimi në thirrjen e lektorit

1. Për titullin e lektorit të gjuhëve të huaja, kandidati duhet t'i plotësojë këto kushte:

   1.1. Të ketë të përfunduar me sukses studimet master në gjuhën e zgjedhur[1];

   1.2. Të ketë aftësi të shkëlqyeshme të gjuhës së zgjedhur;

   1.3. Të ketë notën mesatare të studimeve baçelor dhe master jo më pak se 8, në secilën prej këtyre studimeve.

2. Lektorët në fakultetet e tjera, pos në fakultetin amë, i kanë të gjitha të drejtat dhe obligimet për mbajtjen e ligjëratave[2].

Neni 10
Kohëzgjatja e emërimit dhe kufizimet për emërim

1. Të gjitha emërimet për tituj si dhe kohëzgjatja e punësimit bëhen në përputhje me dispozitat përkatëse të Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren.

2. Avancimi nuk është proces automatik, por është konkurrues dhe meritor për të gjitha pozitat.

3. Anëtarët e personelit akademik që nuk janë në marrëdhënie të rregullt pune primare në Universitetin "Ukshin Hoti" ose e kanë të pezulluar marrëdhënien e punës në përputhje me legjislacionin në fuqi nuk mund të marrin pjesë në procedurën e avancimit në thirrjen akademike për periudhën sa nuk e kanë statusin e marrëdhënies se rregullt të

[1] Përparësi do të kenë folësit e gjuhës amëtare.
[2] Ligjëratave dhe ushtrimeve.

punës primare dhe kanë pezulluar marrëdhënien e punës me Universitetin "Ukshin Hoti", përkatësisht nuk paraqesin dëshmi se kanë hequr dorë nga marrëdhënia e rregullt e punës në institucionin tjetër apo heqin dorë nga pezullimi i marrëdhënies së punës . Përjashtimisht, ky paragraf nuk vlen për deputetet e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

4. Anëtarët e personelit akademik që gjatë ushtrimit të ndonjë funksioni publik sipas legjislacionit në fuqi përkatësisht kur marrëdhënia e punës është e pezulluar dhe themelojnë marrëdhënie të rregullt me institucionin tjetër atëherë i humb statusi i punës përkatësisht rektorit i Universitetit nxjerr vendim mbi përfundimin e marrëdhënies së punës.

5. Emërimi në thirrjet e profesorit bëhet sipas renditjes: profesor asistent, profesor i asocuar dhe profesor i rregullt. Nuk lejohet tejkalimi i thirrjes apo emërimi i parakohshëm.

6. Kriteri i moshës së përcaktuar si në nenin 174 të statutit vlen për kandidatët, të cilët aplikojnë për themelimin e marrëdhënies së rregullt të punës dhe do të merret në konsideratë deri në ditën e mbylljes së afatit për aplikim në konkurs. Nëse 1 kandidat ka qenë i angazhuar në Universitetin "Ukshin Hoti" Prizren, në cilësinë e bashkëpunëtorit të jashtëm apo me honorar para moshës së përcaktuar sipas nenit 174 të statutit, kjo nuk nënkupton që për të njëjtin nuk aplikohet kriteri i moshës së paraparë me statut në momentin e themelimit të marrëdhënies së rregullt të punës.

7. Bazuar në Ligjin e Punës në fuqi, kontrata për një periudhë të rregullt pune për një periudhë të caktuar, që ripërtërihet në mënyrë të qartë ose të vetëkuptueshme për një periudhë të punësimit më të gjatë se 10 vjet, konsiderohet si kontratë për një periudhë të pacaktuar kohore.

8. Në Universitetin "Ukshin Hoti" Prizren nuk lejohet rekrutimi/angazhimi i kandidatëve brenda ndonjërës prej strukturave themelore organizative (katedër, degë, departament apo program), nëse brenda atyre strukturave të njëjtit kanë një marrëdhënie të rregullt pune apo të angazhuar familjarë të ngushtë (në relacionin bashkëshortor, prind-fëmijë, vëlla-motër, motër-motër, vëlla-vëlla dhe anasjelltas).

9. Kandidatet të cilët kanë statusin e rregullt të punës në ndonjërën nga IAL-të të akredituara në Kosovë dhe jashtë saj apo institucione tjera publike apo private, në rast se aplikojnë në konkurs të UUHP-së dhe përzgjidhen si kandidat të suksesshëm para nënshkrimit të kontratës duhet të dorëzojnë dëshmi për dorëheqjen nga institucioni paraprak.

10. Personeli akademik nga universitetet tjera publike apo personeli akademik që e ka humbur statusin e rregullt të stafit akademik në Universitetin "Ukshin Hoti" (nuk kanë kontratë të vazhdueshme me UUHP-në) aplikojnë për të krijuar marrëdhënie të re me Universitetin" Ukshin Hoti" Prizren, konsiderohen të barasvlershëm me kandidatët tjerë në procedurë dhe në rast se rezulton si kandidat i suksesshem e fiton thirrjen e profesorit asistent, kurse nëse është doktor shkence dhe thirrjen asistent nëse është master ose magjistër.

11. Shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi në Republikën e Kosovës themelojnë marrëdhënie pune sipas Ligjit të Punës, nën kushtet dhe kriteret e përcaktuara me ligj të veçantë për punësimin e shtetasve të huaj dhe sipas konventave ndërkombëtare.

Neni 11
Procedurat e konkursit

1. Procedura përzgjedhëse për emërim, riemërim ose avancim do të bëhet në mënyrë transparente dhe me shpalljen e konkursit publik për pozitën përkatëse përkatësisht:
   1.1. Për pozitat e reja të punës pas shqyrtimit të kërkesave të njësive akademike nga rektori i Universitetit i dërgon në Këshillin Drejtues për miratim.
   1. 2. Për pozitat riemërim dhe avancim të njëjtat duhet të iniciohen nga dekanët e njësive akademike nëpërmjet rektorit dërgohet në Këshillin Drejtues. Miratimi i këtyre pozitave duhet të bëhet për një periudhë më të gjatë përkatësisht planifikimi duhet të bëhet jo më pak se 12 muaj nga skadimi i kontratave.

2. Konkursi për emërim, riemërim dhe avancim shpallet me vendim të senatit, pas aprovimit të propozimeve të fakulteteve.

3. Fakultetet nuk mund të kërkojnë shpalljen në konkurs të pozitave, të cilat lidhen me personelin e rregullt, të cilit i kanë mbetur më pak se 12 muaj deri në pension, përveç në rastet kur rrezikohet akreditimi i programit përkatës.

4. Personeli në marrëdhënie të rregullt pune, sipas paragrafit 3 të këtij neni, nuk ka të drejtë të aplikojë në konkurs, meqë të njëjtit, me vendim të rektorit, i vazhdohet kontrata për periudhën e mbetur deri në pension.

5. Personelit të emëruar për pozitat, sipas paragrafit 3 të këtij neni, i lëshohet kontrata valide e punës pas pensionimit të personelit përkatës të rregullt në ato pozita.

6. Fakultetet, duhet t'i bazojnë propozimet e tyre në nevojat reale, përkatësisht në numrin e mjaftueshëm të fondit të orëve në programet e akredituara, të cilat korrespondojnë me fondin e nevojshëm për vend pune, për t'u zgjedhur në thirrjen e mësimdhënësit, asistentit apo lektorit.

7. Propozimet për pozita të reja me normë të plotë mund të merren parasysh nëse fakulteti ofron dëshmi që për atë pozitë brenda një viti akademik ekziston fond i orëve:

   7.1. Për pozitë të mësimdhënësit së paku 50 % të orëve të parapara për normë të plotë të jenë ligjërata nga lëndët obligative. Norma e plotë përllogaritet brenda një viti akademik;

   7.2. Për pozitë të asistentit dhe lektorit së paku 50 % të orëve të parapara për normë të plotë të jenë ushtrime nga lëndët obligative, kurse pjesa tjetër e orëve ushtrime nga lëndët zgjedhore. Norma e plotë përllogaritet brenda një viti akademik.

7.3. Njësitë akademike duhet të kujdesen që fondi i orëve të jetë brenda normave të përcaktuara me aktet juridike të brendshme të UUHP-së dhe legjislacionin në fuqi. Pra, nuk mund të tejkalohet fondi i përcaktuar përjashtimisht në rastet kur ky fond plotësohet dhe lënda përkatëse e tejkalon.

8. Rektori, me një arsyetim të bazuar, mund t'i propozojë senatit shpalljen e konkursit për plotësimin e vendeve të caktuara të punës për personelin akademik, edhe nëse ai vend pune nuk është paraparë me propozimin e fakultetit.

9. Konkursi duhet të përmbajë referencën e neneve përkatëse të Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren dhe të kësaj rregulloreje.

10. Konkursi shpallet në ueb-faqen e universitetit. Kohëzgjatja e konkursit është pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike dhe publikohet në faqen zyrtare të konkurseve publike sipas dispozitave të Ligjit për Zyrtaret Publik.

11. Aplikantët duhet të dorëzojnë dokumentet e nevojshme në formë të shtypur dhe në formë elektronike.

12. Dokumentacioni i shtypur dhe versioni elektronik (i skanuar) duhet të dorëzohen në fakultetin përkatës, kurse në adresën zyrtare të Universitetit "Ukshin Hoti" vetëm versioni elektronik.

Neni 12
Komisionet vlerësuese

1. Fakulteti është i obliguar që për çdo pozitë të shpallur në konkurs ta caktojë komisionin vlerësues, miratimin përfundimtar e merr Senati i Universitetit.

2. Brenda 10 ditëve[3] pas hapjes së konkursit, dekani i fakultetit thërret mbledhjen e Këshillit të fakultetit, në të cilën merret vendimi për emërimin e komisioneve vlerësuese dhe komisionit të ankesave, në përbërje prej 3 anëtarëve.

3. Anëtarët e komisionit të ankesave janë përfaqësues nga personeli akademik, por jo nga strukturat udhëheqëse të fakultetit dhe departamenteve përkatëse si dhe anëtarët e komisioneve vlerësuese.

4. Anëtarë të komisionit vlerësues nuk mund të jenë personat në strukturat menaxhuese në nivel të fakultetit dhe universitetit.

5. Komisioni vlerësues emërohet nga Këshilli i fakultetit, bazuar në propozimin e katedrës, degës, departamentit ose programit. Përjashtimisht, kur është e pamundur që

[3] Të gjitha afatet në këtë rregullore nënkuptojnë ditët kalendarike, përveç nëse specifikohet ndryshe.

propozimi të bëhet nga katedra, dega, departamenti ose programi, komisioni vlerësues ose anëtari i komisionit vlerësues emërohet direkt nga Këshilli i fakultetit.

6. Pjesëmarrja e personelit akademik në komisione vlerësuese është detyrim pune dhe si i tillë është i obligueshëm për zbatim, përveç rasteve kur identifikohet konflikti i interesit apo refuzimi arsyetohet për shkak të gjendjes shëndetësore, e cila dëshmohet me raport të mjekut.

7. Komisionet vlerësuese janë organe me kredibilitet të lartë profesional, akademik dhe etik.

8. Në komisione vlerësuese duhet të jenë së paku 2 anëtarë nga fusha e ngushtë me lëndët, për të cilat është shpallur konkursi.

9. Anëtarët e komisionit vlerësues duhet të kenë thirrje më të lartë akademike ose së paku të njëjtë me pozitën, për të cilën ka aplikuar kandidati.

10. Anëtari i komisionit vlerësues me thirrje më të lartë akademike me automatizëm është kryetar i komisionit. Në rastet kur më shumë se 1 anëtar i komisionit ka thirrje më të lartë, përkatësisht në rastet kur të gjithë anëtarët e komisionit kanë thirrje të njëjtë me pozitën, për të cilën ka aplikuar kandidati, kryetar do të jetë anëtari më i vjetër në moshë, përkatësisht anëtari i caktuar me konsensus të anëtarëve tjerë të komisionit.

11. Në mungesë të numrit të mjaftueshëm të profesorëve si në paragrafin 8 dhe 9 të këtij neni, në përbërje të komisionit vlerësues mund të emërohen edhe profesorë nga katedra, degë, departamente ose programe tjera, por në këtë rast kryetari i komisionit duhet të jetë nga radha e profesorëve të katedrës, degës, departamentit ose programit, për të cilin janë duke u vlerësuar aplikacionet.

12. Në mungesë të anëtarëve në marrëdhënie të rregullt pune si në paragrafët 8, 9 dhe 11, anëtarë të komisionit vlerësues mund të jenë edhe personat e pensionuar dhe me angazhim në Universitetin "Ukshin Hoti" Prizren, që kanë thirrjet e nevojshme akademike nga fusha përkatëse dhe të cilët nuk e kanë kaluar moshën 70 vjeçare, përjashtimisht profesorëve emeritus, të cilët kanë kontratë për mbajtjen e mësimit edhe mbi këtë moshë.

13. Anëtarët e komisionit vlerësues mund të jenë edhe nga universitete tjera të akredituara në vend dhe jashtë vendit, me kusht që të njëjtit të jenë nga fusha e lëndëve, për të cilat është shpallur konkursi, dhe të kenë thirrje më të lartë akademike ose së paku të njëjtë me pozitën, për të cilën ka aplikuar kandidati. Në këtë rast, së paku 1 anëtar i komisionit duhet të jetë në marrëdhënie të rregullt pune në Universitetin "Ukshin Hoti" Prizren. Në rastet kur komisioni vlerësues ka 2 anëtarë të jashtëm, anëtari nga Universiteti "Ukshin Hoti" me automatizëm është kryetar i komisionit.

14. Në rast të identifikimit të konfliktit të interesit apo për shkak të gjendjes shëndetësore, e cila dëshmohet me raport të mjekut, anëtari i komisionit, në afat prej 5 ditëve pas formimit të komisionit vlerësues, mund të deklarojë me shkrim tërheqjen e tij nga komisioni. Në këtë rast, dekani i fakultetit, brenda 7 ditëve, thërret mbledhjen e

Këshillit të fakultetit dhe kërkon nga Këshilli plotësimin, përkatësisht emërimin e komisionit tjetër vlerësues.

15. Administrata e fakultetit duhet t'ia ofrojë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm komisionit vlerësues.

16. Kryetari i komisionit vlerësues është i obliguar t'i thërrasë anëtarët e tjerë të komisionit dhe në bashkëpunim me ta të hartojë raportin e vlerësimit.

17. Komisioni vlerësues është i obliguar që, në afat prej 15 ditësh pas mbylljes së konkursit, ta dorëzojë raportin e vlerësimit për kandidatët, të cilët kanë aplikuar për pozitën e caktuar. Në rast të mosdorëzimit të raportit brenda kësaj periudhe, anëtarët përkatës të komisionit vlerësues dërgohen në Këshill të Etikës.

18. Këshilli i fakultetit përkatës ndryshon përbërjen e komisionit vlerësues, përkatësisht emëron komision të ri (bazuar në paragrafin 5 të këtij neni), nëse konstatohet se komisioni nuk ka respektuar afatin e paraparë në paragrafin 17.

19. Pas ndryshimit të përbërjes së komisionit vlerësues, Këshilli i fakultetit i jep afat komisionit edhe dhjetë (10) ditë shtesë që ta hartojë dhe ta dorëzojë raportin për kandidatët e paraqitur në konkurs.

20. Komisioni vlerësues është i obliguar që gjatë punës së tij të respektojë dispozitat e Ligjit për Arsimin e Lartë, Statutin e Universitetit, këtë rregullore, kushtet e konkursit dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.

21. Nëse komisioni vlerësues e sheh të nevojshme, i fton në intervistë të gjithë kandidatët të cilët emërohen për herë të parë në Universitetin "Ukshin Hoti" Prizren.

22. Komisioni vlerësues është i obliguar që t'u japë përparësi kandidatëve, të cilët i plotësojnë kriteret e nevojshme dhe të cilët, bazuar në vlerësimin e përgjithshëm të aktivitetit të tyre shkencor, profesional dhe akademik, janë më të mirë në krahasim me kandidatët e tjerë. Komisioni duhet të arsyetojë rekomandimin e bërë në frymën e këtij paragrafi.

23. Komisioni vlerësues harton raportin, bazuar në formularin unik të përgatitur nga Rektorati, në të cilin përfshihet propozimi për emërimin, riemërimin ose avancimin e kandidatëve në numrin e kërkuar me konkurs dhe në të cilin identifikohen qartë kandidatët, të cilët nuk propozohen për t'u emëruar.

24. Komisioni vlerësues është i obliguar të shkruajë raport edhe për kandidatët, të cilët i plotësojnë kushtet minimale, por të cilët nuk janë propozuar të emërohen. Për kandidatët, të cilët nuk i plotësojnë kushtet minimale mjafton të ceken kushtet të cilat nuk janë plotësuar.

25. Pas hartimit dhe nënshkrimit të raportit nga të 3 anëtarët, kryetari i komisionit vlerësues është i obliguar që ta dorëzojë raportin në Këshillin e fakultetit përkatës.

26. Vlerësimet në raport bëhen në përputhje me kriteret dhe kërkesat e përcaktuara në statut dhe të detajuara në këtë rregullore. Nëse komisioni vlerësues i vlerëson me pikë të barabarta kandidatët, Këshilli i fakultetit vendos për kandidatin që do t'i propozohet Senatit të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren. Nëse anëtarët e komisionit vlerësues kanë mendime të ndryshme në lidhje me propozimin për emërimin, riemërimin ose avancimin e kandidatit, anëtarët janë të obliguar që të paraqesin një "propozim të ndarë" për Këshillin e fakultetit përkatës. Në raste të tilla, Këshilli i fakultetit i diskuton propozimet dhe e dorëzon në rektorat propozimin që është miratuar nga Këshilli, duke përfshirë informacionin për mendimet e ndara. Këshilli i fakultetit mban të drejtën të refuzojë propozimet e bëra dhe të emërojë komision të ri ose të miratojë një nga propozimet e anëtarëve të komisionit për të njëjtën pozitë.

27. Anëtarët e komisionit vlerësues mbajnë përgjegjësi ligjore, disiplinore dhe etike për vërtetësinë dhe plotësinë e të dhënave të shënuara në raportin e vlerësimit dhe për rekomandimet që bëjnë do të sanksionohen sipas kodit të etikës dhe dispozitave tjera ligjore në fuqi, nëse të njëjtat bien qartazi ndesh me Statutin e Universitetit dhe me këtë rregullore.

28. Pozitat menaxhuese në kuptim të këtij neni, konsiderohen si në vijim: Rektor; Prorektorë, Dekan dhe Prodekanë.

Neni 13
Procedura pas dorëzimit të raportit nga komisioni vlerësues

1. Këshilli i fakultetit, pas dorëzimit të raportit nga komisioni vlerësues, është i obliguar që në mbledhjen e radhës, jo më vonë se 7 ditë, ta shqyrtojë raportin.

2. Pas konstatimit të Këshillit të fakultetit përkatës se raportet vlerësuese janë shkruar në pajtim me këtë rregullore dhe janë nënshkruar nga anëtarët e komisionit vlerësues, të njëjtat, brenda 3 ditëve, përcillen në versionin elektronik pranë Zyrës për Çështje Akademike të Universitetit.

3. Zyra për Çështje Akademike, nëse konstaton se ndonjë nga raportet e dorëzuara nga Këshilli i fakultetit përkatës nuk është në rregull me dokumentacion, menjëherë kërkon nga prorektori për mësim që ta obligojë fakultetin përkatës që të kompletojë dokumentacionin para se të dalë në buletin.

4. Zyra për Çështje Akademike e universitetit është e obliguar që brenda 7 ditëve pas marrjes së raporteve vlerësuese nga ana e këshillave të fakulteteve, të hartojë buletinet dhe të njëjtit t'i publikojë në ueb-faqen e universitetit.

5. Buletinet duhet të qëndrojnë të publikuara në ueb-faqe të universitetit në kohëzgjatje prej 15 ditësh nga dita e publikimit.

6. Gjatë fazës së publikimit të raporteve të komisioneve vlerësuese në buletine, kandidatët e pakënaqur kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë në Këshillin e fakultetit përkatës.

7. Ankesat eventuale të kandidatëve duhet të dorëzohen në Administratën e fakultetit përkatës.

8. Këshilli i fakultetit është i obliguar që pas kalimit të afatit të buletineve, në afat prej 10 ditësh, të vlerësojë raportet e komisioneve vlerësuese dhe të vendosë për miratim ose jo të atyre raporteve.

9. Gjatë shqyrtimit të raporteve, Këshilli i fakultetit është i obliguar që të shqyrtojë edhe raportin e komisionit të ankesave lidhur me ankesat e kandidatëve, të parashtruara në fazën e publikimit të buletineve dhe brenda 7 ditëve të njoftojë me shkrim palën e ankuar.

10. Këshilli i fakultetit është i obliguar që, pas shqyrtimit dhe miratimit ose jo të raporteve të komisioneve vlerësuese, vendimin përkatës dhe detajet e tjera rreth shqyrtimit të ankesave t'i dorëzojë brenda 3 ditëve pranë Zyrës për Çështje Akademike të universitetit.
11. Zyra për Çështje Akademike, nëse konstaton se ka ndonjë lëshim nga fakultetet përkatëse lidhur me miratimin ose jo të raporteve të komisioneve vlerësuese, pas fazës së diskutimit publik, është e obliguar që ta informojë prorektorin për mësim, i cili kërkon nga dekanati i fakultetit përkatës që t'i kompletojë lëndët.

Neni 14
Shqyrtimi i propozimit të Këshillit të fakultetit në Senat

1. Komisioni i studimeve në nivel të Universitetit shqyrton konkursin dhe dokumentet lidhur me rregullsitë e procedurës dhe të propozimeve nga fakultetet për kandidatët e paraqitur në konkurs. Në bazë të nenit 28, paragrafi 1.16 të Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti", rektori mund të formon komision këshillëdhënës lidhur me rregullsinë e procedurës dhe propozimeve nga fakultetet për kandidatët e paraqitur në konkurs.

2. Në një afat prej 30 ditësh pas pranimit të propozimeve të këshillit të fakultetit, Zyra për Çështje Akademike përgatitë për Senat pasqyrat me propozimet përkatëse, përfshirë propozimin e rektorit lidhur me propozimet e Këshillit të fakultetit.

3. Vendimi i Senatit lidhur me propozimet e këshillave të fakulteteve merret më së largu njëzet (20) ditë pas përgatitjes së pasqyrave nga Zyra për Çështje Akademike.

4. Nëse Senati vendos ta refuzojë propozimin e Këshillit të fakultetit, lënda përkatëse, brenda 3 ditëve, kthehet për rishqyrtim në Këshillin e fakultetit.

5. Këshilli i fakultetit obligohet që brenda 7 ditëve pas pranimit të vendimit të Senatit, t'i rishqyrtojë lëndët për rivlerësim dhe vendimin përkatës ta dorëzojë, brenda 3 ditëve, pranë Zyrës për Çështje Akademike të universitetit.

6. Nëse Këshilli i fakultetit, edhe pas rishqyrtimit, e sjell të njëjtin propozim, Senati, në një afat jo më të gjatë se 20 ditë nga pranimi i tyre, merr vendim përfundimtar.

7. Senati rezervon të drejtën që në çdo moment ta tërheqë njohjen e publikimit në revistat e dyshimta ose botuesit e dyshimtë, por para vlerësimit përfundimtar të kandidatit.

Neni 15
Vendimi, periudha e ankimimit dhe kohëzgjatja e konkursit

1. Procedura e votimit në Senat për propozimet e këshillit të fakultetit lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e anëtarëve të personelit akademik bëhet sipas rregullores së punës së Senatit.

2. Anëtari i personelit akademik, i cili ka vlerësim pozitiv nga instancat paraprake, por i cili nuk i fiton votat e nevojshme të anëtarëve të Senatit për avancim, mbetët në thirrjen e njëjtë.

3. Ndaj vendimit të Senatit, në afat jo më larg se 30 ditë pas pranimit në dorëzim të vendimit, mund të bëhet ankesë në Komisionin e Senatit për Ankesa dhe Parashtresa, që shërben si instancë e parë dhe e fundit e ankimimit në UUHP. Vendim i komisionit të Ankesave është përfundimtar në procedurë administrative dhe ndaj tij mund të iniciohet kontest pune në gjykatën kompetente në përputhje me Ligjin e Punës.

4. Konkursi për emërim, riemërim ose avancim të personelit akademik duhet të përmbyllet me vendime përkatëse të Senatit "Ukshin Hoti" Prizren, për të gjitha vendet e shpallura, në një periudhë jo më të gjatë se 175 ditë nga dita e shpalljes.

5. Për raste të veçanta para arritjes së propozimit në Senat, me kërkesë të rektorit, afati i të gjithë procedurës mund të zgjatet edhe maksimumi 30 ditë.

6. Nëse konkursi nuk realizohet në tërësi apo pjesërisht brenda afatit të përcaktuar si në paragrafin 4 të këtij neni, atëherë vendet përkatëse të parealizuara mund të rishpallen në konkursin e radhës sipas kërkesës së fakultetit.

Neni 16
Dispozitat kalimtare

1. Për emërimet dhe avancimet e personelit akademik nga data 06 janar 2025 do të merren parasysh vetëm punimet, të cilat janë të publikuara në revista ndërkombëtare dhe të indeksuara në platformat vijuese:
   1.1.Web of science (http://mjl.clarivate.com) në databazat:
   - Science Citation Index Expanded (SCIE);
   - Social Sciences Citation Index (SSCI);
   - Arts & Humanities Citation Index (AHCI)

   1.2. Scopus (Elsevier) (https://www.scopus.com).

2. Ky nen nuk do të aplikohet për riemërime në thirrjet akademike të fituara para hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje.
3. Me kërkesë të stafit akademik, thirrja/kontrata e të cilëve është në pragë të përfundimit të lejohet vazhdimi i kontratës në thirrjen e njëjtë më së largu deri një vit. Kjo dispozitë kalimtare vlen një vit nga data e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje.

Neni 17
Dispozitat përfundimtare

1. Obligohen njësitë akademike që fondin e përcaktuar për normat e rregullta t'i harmonizojnë brenda akteve të përcaktuara në afat prej 6 muajsh nga hyrja në fuqi e kësaj rregullore. Propozimi i njësive akademike duhet t'i përfshijë thirrjet dhe kontratat me të gjata se 1 vjet nga data kur hyn në fuqi kjo rregullore, pas shqyrtimit të këtyre propozimeve të njëjtat përcillen në Këshillin Drejtues për miratim përfundimtar.
2. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohet Rregullorja Nr. 01/161, e datës 29.7.2020, për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në Universitetin "Ukshin Hoti" Prizren.

3. Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit.

Kryesues i Senatit të Universitetit

Prof. Asoc. Dr. Mentor Alishani – rektor

Shtojca I

FORMULAR PËR AKTIVITETIN ARSIMOR (MËSIMDHËNIEN)

Tabela I.1 Aktivitetet mësimore, me përqendrim te përvoja relevante

Emri & niveli i lëndës sipas viteve të periudhës që recensohet	Viti & Semestri kur ligjërohet	Numri i përafërt i studentëve	Numri i orëve për semestër	Forma e mësimdhënies (p.sh., ligjërata, mësim në ekip, tutorim, mbikëqyrje e punës praktike, online, punë në laborator)

Tabela I.2 Cilësia në mësimdhënie[4]

Aktiviteti	Vlerësimi i aktivitetit
Vlerësimi i mësimdhënies nga studentët etj. (*pozitiv/negativ*)	

Tabela I.3 Mentorimi

Emri i kandidatit	Diploma / Niveli i studimit[5]	Data e regjistrimit / lejimit të punimit	Në proces	Data e përfundimit

[4] Fillon të zbatohet nga momenti i sigurimit të sistemit meritor të vlerësimit të studentëve.

[5] Punimi i diplomës në studimet 5 ose 6 vjeçare, lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik, konsiderohet ekuivalent me punimin e nivelit Master.

Tabela I.4 Shpërblime dhe trajnime në mësimdhënie

Shpërblimi/Trajnimi	Data/Periudha	Përshkrimi i shkurtë

Shtojca II

FORMULAR PËR AKTIVITETIN HULUMTUES, SHKENCOR DHE PROFESIONAL

A. Autori i parë, autori korrespondent dhe punimet e publikuara në revista ndërkombëtare në frymën e neneve 171, 172 dhe 175 të Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren.

Në përputhje me Statutin e Universitetit, punimi i publikuar në fushën në të cilën aplikon kandidati, në revistë ndërkombëtare shkencore mund të shfrytëzohet për nevoja të emërimit, riemërimit dhe avancimit nga autori i parë i punimit dhe nga autori korrespondent.

A.1. Për autorin korrespondent të punimit të publikuar në revistë ndërkombëtare shkencore vlejnë përkufizimet vijuese:

a) Si autor korrespondent konsiderohet autori i cili është i identifikuar si i tillë në punimin e publikuar;

b) Nëse në punimin e publikuar janë specifikuar më shumë se 1 autor korrespondent, si autor korrespondent konsiderohet autori i parë i identifikuar si i tillë;

c) Nëse në punimin e publikuar janë vetëm 2 autorë dhe autori korrespondent nuk është specifikuar, autori i dytë konsiderohet si autor korrespondent.

A.2. Bazuar në Statutin e UUHP-së dhe aktet tjera ligjore në fuqi, si punime të publikuara në revista ndërkombëtare shkencore, gjatë vlerësimit të kandidatëve të paraqitur në konkurs, vlejnë punimet e publikuara në fushën, në revista të cilat janë të indeksuara në bazat përkatëse akademike dhe të kategorizuara si në vijim:

A.2.1. Punimet e publikuara në revista, të cilat janë të indeksuara në bazat akademike vijuese barasvlerësohen me 1:

1. Web of Science (http://mjl.clarivate.com/)
2. Scopus (Elsevier) (https://www.scopus.com)
3.

A.3. Punimet e publikuara në revistat si në nënparagrafët A.2.1, nuk merren parasysh nëse në fazat e vlerësimit deri në momentin e marrjes së vendimit përfundimtar konstatohet që revistat përkatëse janë të përfshira në lista të revistave ose botuesve të dyshimtë[6].

A.4. Punimet e publikuara në revistat si në nënparagrafët A.2.1, nuk pranohen nëse janë të publikuara në revista të Kosovës ose vendeve fqinje. Përjashtimisht për kandidatët

[6] Revista të dyshimta konsiderohen revistat, të cilat nuk e aplikojnë procesin e vërtetë të recensionit profesional (peer review), nuk kanë ISSN të vërtetë, nuk kanë uebfaqe ose kanë një të tillë të dyshimtë, personi juridik apo fizik botues nuk ka adresë ose numër kontakti, deklaron adresë ose numër kontakti fiktiv, paraqet indeksim ndërkombëtar të rremë, deklaron faktor ndikimi të rremë, botuesi i tyre është i dyshimtë në kuptimin e mënyrës së menaxhimit dhe paletës së revistave që publikon, shih p.sh. https://beallslist.net/

e të gjitha fushave pranohen edhe revistat e vendeve fqinje nëse të njëjtat janë të indeksuara në bazat A.2.1, alineja 1 dhe 2.

Tabela II.1 Publikimet në revista ndërkombëtare që plotësojnë kushtet si në paragrafët A1 deri A4

Nr.	Autorët (renditja si në punim)	Titulli i punimit	Revista	Vëllimi, nr., faqet, viti	Linku identifikues[7]

Vërejtje: Për thirrjen prof. dr. kandidati duhet t'i ketë së paku 5 punime, për thirrjen prof. asoc. dr. së paku 3 punime, për thirrjen prof. ass. dr. së paku 1 punim nga kjo kategori

B. Publikimet në revista akademike ose shkencore, ndërkombëtare ose vendore që nuk janë përfshirë në tabelën II.1. (në cilësinë e autorit të parë ose bashkautorit)

Tabela II.2 Publikimet në revista akademike ose shkencore ndërkombëtare

Nr.	Autorët (renditja si në punim)	Titulli i punimit	Revista	Vëllimi, nr., faqet, viti

[7] Komisioni vlerësues është i obliguar të shënojë linkun, nëpërmjet të cilit dëshmohet indeksimi i punimit, përkatësisht revistës, në bazën e caktuar akademike, respektivisht linkun e punimit në revistën përkatëse të nën paragrafit A.2.4

Tabela II.3 Publikimet në revista akademike ose shkencore vendore

Nr.	Autorët (renditja si në punim)	Titulli i punimit	Revista	Vëllimi, nr., faqet, viti

C. Publikimet e monografive, librave, kapitujve të librave, dispensave, përkthimeve në fushën e kandidatit (në cilësinë e autorit të parë ose bashkautorit)

Tabela II.4 Publikimet e monografive, librave, kapitujve të librave, dispensave, përkthimeve etj., në gjuhë të huaja

Nr.	Autorët (renditja si në punim)	Titulli i publikimit	Lloji i publikimit	Shtëpia botuese, vendi, viti

Tabela II.5 Publikimet e monografive, librave, kapitujve të librave, dispensave, përkthimeve etj., në gjuhën shqipe

Nr.	Autorët (renditja si në punim)	Titulli i publikimit	Lloji i publikimit	Shtëpia botuese, vendi, viti

D. Publikimet nga kongreset, konferencat, simpoziumet, seminaret, workshopet (në cilësinë e autorit të parë ose bashkautorit)

Tabela II.6 Publikimet nga kongreset, konferencat, simpoziumet, seminaret, workshopet në nivel ndërkombëtar (jashtë vendit)

Nr.	Autorët (renditja si në punim)	Titulli i punimit	Konferenca, simpoziumi	Vëllimi, nr., faqet, viti

Tabela II.7 Publikimet nga kongreset, konferencat, simpoziumet, seminaret, workshopet vendore

Nr.	Autorët (renditja si në punim)	Titulli i punimit	Konferenca, simpoziumi	Vëllimi, nr., faqet, viti

E. Aktiviteti tjetër kërkimor-shkencor

Tabela II.8 Ligjëratat-prezantimet gojore shkencore në konferenca, simpoziume, punëtori shkencore dhe në universitete (si ligjërues i ftuar), nga fusha e kandidatit

Nr	Autorët (renditja si në Ligjërate/Prezantim)	Titulli e prezantimit	Lloji i ligjëratës (Konferencë, Simpozium, Punëtori, Universitet)	Viti, Vendi

Tabela II.9 Redaktor/Recensent në revistat akademike apo shkencore

Nr	Kontributi (redaktor/recen sent)	Autori origjinal i punimit	Titulli i punimit të recensuar	Revista e cila është redaktuar ose për të cilën është shkruar recensioni	Vendi, Viti

Tabela II.10 Kontribute tjera shkencore dhe profesionale

Nr	Autorët (renditja si në kontributin shkencor)	Lloji i kontributit shkencor	Viti, Vendi

F. Kontributi në projekte të kërkimeve themelore dhe të aplikueshme

Tabela II.11 Pjesëmarrja e dëshmuar në programe ose projekte të kërkimeve themelore dhe të aplikueshme

Nr	Programi/ projekti shkencor	Periudha kohore	Institucioni/ Vendi	Pozita në program, projekt/ Kontributi

G. Patente në nivel ndërkombëtar ose kombëtar

Tabela II.12 Patentat zyrtare në nivel ndërkombëtar dhe kombëtar

Nr	Autorët (renditja si në patentin e zyrtarizuar)	Titulli i patentit	Institucioni/ Vendi, Viti i zyrtarizimit	Faqet

Shtojca III

FORMULAR PËR AKTIVITETIN SHËRBYES

Kjo shtojcë përfshin aktivitetin në shërbim të universitetit, fakultetit dhe komunitetit nëpërmjet shërbimit specifik, përkatësisht pjesëmarrjes në komunitete/komisione akademike, administrative ose ekipe profesionale.

Tabela III.1 Shërbimi në lidhje me universitetin

Shërbimi, përkatësisht pozita në komunitet/komision/ekip	Kohëzgjatja	Përshkrim i shkurtë i shërbimit

Tabela III.2 Shërbimi në lidhje me fakultetin

Shërbimi, përkatësisht pozita në komunitet/komision/ekip	Kohëzgjatja	Përshkrim i shkurtë i shërbimit

Tabela III.3 Shërbimi në lidhje me komunitetin

Shërbimi, përkatësisht pozita në komunitet/komision/ekip	Kohëzgjatja	Përshkrim i shkurtë i shërbimit

Shtojca IV

a) Vlerësimi kuantitativ i aktiviteteve të kandidatëve, të cilët emërohen për herë të parë në thirrjen prof. ass. dr.[8]

A	Punimi i publikuar në revista ndërkombëtare	Pikët	
		Autor i parë	**Autor korrespondent**
	Web of science (Clarivate): SCIE, SSCI, AHCI Scopus: Q1, Q2	20	10
	Scopus: Q3, Q4	14	7
B	**Monografia**	**Autor i parë**	**Bashkautor**
	Punimi i doktoratës në formë monografie, i publikuar si botim i veçantë, në Kosovë ose vende tjera, me ISBN dhe i kataloguar [9]	5	-
	Monografi e veçantë shkencore ndërkombëtare, në fushën e kandidatit, me ISBN dhe e kataloguar	10	5
	Monografi e veçantë shkencore, në fushën e kandidatit, e botuar në Kosovë, me ISBN dhe e kataloguar	5	2.5
C	**Mësimdhënia**		
	Certifikatë nga QPM-ja	3	
	Certifikatë për mësimdhënie nga institucione ndërkombëtare	3	
	Vlerësimi i komisionit lidhur me mësimdhënien dhe përvojën profesionale përkatëse	0-14	
D	**Tekstet mësimore**	**Autor i parë**	**Bashkautor**
	Libër universitar	5	2.5
	Teksti mësimor ndërkombëtar. Tekst mësimor konsiderohet libri ndërkombëtar për nevoja të studentëve në fushën përkatëse. Libri duhet të jetë i botuar në formë të shtypur apo elektronike, të jetë i shqyrtuar nga së paku 2 recensentë, së paku me titull dr. sc. në fushën e njëjtë ose të afërt dhe të ketë ISBN	5	2.5

[8] Kandidatët që kanë përfunduar studimet e baçelor dhe master në UUHP dhe të cilët i plotësojnë kriteret e Statutit të UUHP-së kanë përparësi ndaj kandidatëve që studimet i kanë përfunduar në institucionet tjera të Arsimit të Lartë të Kosovës dhe vendeve fqinje të Kosovës, pavarësisht pikëve të grumbulluara në kategoritë përkatëse. Kjo përparësi nuk aplikohet në raport me kandidatët, të cilët tashmë janë në marrëdhënie të rregullt të punës në UUHP.

[9] Në rastin e kandidatëve që kanë doktoruar në universitetet jashtë Kosovës dhe vendeve fqinje, mjafton dëshmia e katologimit të punimeve të doktoratës në biblioteka përkatëse.

	Teksti mësimor në gjuhën shqipe apo në ndonjërën gjuhë të programit studimor e aplikueshme brenda UUHP-së. Tekst mësimor konsiderohet libri për nevoja të studentëve në fushën përkatëse. Libri duhet të jetë i botuar në formë të shtypur apo elektronike, të jetë i shqyrtuar nga së paku 2 recensentë, së paku me titull dr. sc. në fushën e njëjtë ose të afërt dhe të ketë ISBN	3	1.5
	Teksti mësimor i përkthyer	2	1
	Teksti për përdorim të brendshëm me ligjërata/ushtrime i botuar në formë të shtypur ose elektronike, i shqyrtuar nga së paku 2 recensentë, së paku me titull dr. sc. në fushën e njëjtë ose të afërt	2	1
E	**Pjesëmarrja në konferenca shkencore**		
	Punim i ftuar dhe prezantuar në sesion plenar në konferencën shkencore ndërkombëtare	4	
	Punim i prezantuar në sesion në konferencën shkencore ndërkombëtare	2	
	Punim i ftuar dhe prezantuar në sesion plenar në konferencën shkencore vendore	2	
	Punim i prezantuar në sesion në konferencën shkencore vendore	1	
F	**Pjesëmarrja në projekte**		
	Udhëheqës i projektit shkencor	3	
	Anëtar i projektit shkencor	1	
	Koordinator i projektit ndërkombëtar	2	
	Projekt profesional, individual ose grupor	1	
G	**Aktivitet shërbyes**		
	Për universitetin	1	
	Fakultetin	1	
	Komunitetin	1	

Minimumi i nevojshëm i pikëve, i cili duhet të arrihet në kategorinë përkatëse, përkatësisht maksimumi i pikëve, i cili mund të ndahet në kategori përkatëse

Thirrja	Kategoria	Numri minimal i pikëve, i cili duhet të arrihet në kategorinë përkatëse	Numri maksimal i pikëve, i cili mund të arrihet në kategorinë përkatëse
Prof. ass. dr.	A	7	40
	B	5	10
	C	6*	20
	D	-	10
	E	-	5
	F	-	7
	G	-	8
		Min. Total = 18	**Max. Total = 100**

*Nuk aplikohet për kandidatët që nuk janë në marrëdhënie të rregullt të punës në UUHP dhe për kandidatët nga UUHP-ja, të cilët në mungesë të kapaciteteve të QPM-së nuk kanë mundur të vijojnë trajnimet përkatëse

b) Vlerësimi kuantitativ i kandidatëve, të cilët emërohen për herë të parë në thirrjen asistentë

A	**Nota mesatare**[10]	**Pikët**	
	Nota mesatare e studimeve baçelor dhe master	Nota mesatare x 3	
B	**Studimet e doktoratës**		
	Përfunduar	10	
	Regjistruar	5	
C	**Përvoja paraprake në arsimin e lartë**		
	2 vjet e më shumë	10	
	2 vjet	6	
	1 vjet	3	
D	**Punimi i publikuar në revista ndërkombëtare**	**Pikët**	
		Autor i parë	**Autor korrespondent**
	Web of science (Clarivate): SCIE, SSCI, AHCI Scopus: Q1, Q2	20	10
	Web of science (Clarivate): ESCI Scopus: Q3, Q4	14	7
E	**Mësimdhënia**		
	Certifikatë nga QPM-ja	3	
	Certifikatë për mësimdhënie nga institucione ndërkombëtare	3	

[10] Nota mesatare llogaritet si mesatare aritmetike e notës në baçelor dhe master, me kusht që të dy notat të jenë mbi 8.

	Vlerësimi i komisionit lidhur me mësimdhënien dhe përvojën profesionale	0-14
F	**Pjesëmarrja në konferenca shkencore**	
	Punim i ftuar dhe prezantuar në sesion plenar në konferencën shkencore ndërkombëtare	4
	Punim i prezantuar në sesion në konferencën shkencore ndërkombëtare	2
	Punim i ftuar dhe prezantuar në sesion plenar në konferencën shkencore vendore	2
	Punim i prezantuar në sesion në konferencën shkencore vendore	1
G	**Pjesëmarrja në projekte**	
	Udhëheqës i projektit shkencor	3
	Anëtar i projektit shkencor	1
	Koordinator i projektit ndërkombëtar	2
	Projekt profesional, individual ose grupor	1
H	**Aktivitet shërbyes**	
	Për universitetin	1
	Fakultetin	1
	Komunitetin	1

Minimumi i nevojshëm i pikëve, i cili duhet të arrihet në kategorinë përkatëse, përkatësisht maksimumi i pikëve, i cili mund të ndahet në kategori përkatëse

Thirrja	**Kategoria**	**Numri minimal i pikëve, i cili duhet të arrihet në kategorinë përkatëse**	**Numri maksimal i pikëve, i cili mund të arrihet në kategorinë përkatëse**
Asistent	A	24	30
	B	-	10
	C	-	10
	D	-	20
	E	-	20
	F	-	4
	G	-	3
	H	-	3
		Min. Total = 24	**Max. Total = 100**